



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

POSTA SHQIPTARE SH.A

Tiranë, më 22.06.2026

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Shërbimi i mirëmbajtjes për Hibrid Mail”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
72267100-0

VLERA E FONDIT LIMIT: 11,645,000 (njëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e dyzet e pesë mijë) Lekë pa TVSH.

**II. ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE TERMAVE TË
REFERENCËS**

Specifikimet teknike dhe termat e referencës janë hartuar në përputhje me nenin 36 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, të ndryshuar, me qëllim garantimin e mirëmbajtjes së vazhdueshme dhe funksionimit normal të sistemit Hibrid Mail, i cili përbën një komponent të rëndësishëm të procesit të përpunimit dhe shpërndarjes së dërgesave postare.

Specifikimet teknike janë përcaktuar bazuar në karakteristikat teknike të pajisjeve ekzistuese, nevojat operacionale të Autoritetit Kontraktor dhe kërkesat për sigurimin e vazhdimësisë së shërbimit. Ato synojnë garantimin e kryerjes së shërbimeve të mirëmbajtjes parandaluese dhe korrigjuese, diagnostikimin e defekteve, zëvendësimin e pjesëve të dëmtuara, si dhe rikthimin në funksionim normal të sistemit brenda afateve të përcaktuara.

Termet e referencës janë hartuar në mënyrë që të sigurojnë:

- mirëmbajtjen e plotë të sistemit Hibrid Mail dhe të gjithë komponentëve përbërës të tij;

- garantimin e disponueshmërisë së personelit teknik të kualifikuar për ndërhyrje dhe asistencë;
- përdorimin e pjesëve të këmbimit origjinale ose të certifikuara nga prodhuesi;
- minimizimin e kohës së ndërprerjes së sistemit dhe garantimin e vazhdimësisë së proceseve operacionale;
- ofrimin e shërbimit sipas standardeve dhe rekomandimeve të prodhuesve të pajisjeve;
- monitorimin dhe raportimin periodik të ndërhyrjeve dhe problematikave të konstatuara.

Specifikimet teknike dhe termat e referencës janë hartuar në mënyrë të tillë që të mos krijojnë kufizime të panevojshme për operatorët ekonomikë, të garantojnë konkurrencë të hapur dhe të ndershme dhe të sigurojnë përmbushjen e nevojave të Autoritetit Kontraktor në përputhje me parimet e transparencës, proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit.

III. ARGUMENTIMI VLERA LIMIT E KONTRATËS,

Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës për procedurën e prokurimit me objekt **“Shërbimi i mirëmbajtjes për Hibrid Mail”**, Autoriteti Kontraktor është bazuar në parashikimet e nenit 76 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Për përcaktimin e fondit limit është zbatuar metoda e parashikuar në pikën 1, shkronja “b” e nenit 76, duke kryer studim tregu dhe duke administruar oferta/kuotime çmimesh nga operatorë ekonomikë që ushtrojnë aktivitetet në fushën objekt prokurimi.

Ofertat e siguruara janë administruar në procesverbalin e përlllogaritjes së fondit limit dhe janë pjesë përbërëse e dosjes së prokurimit. Vlera limit e kontratës është përlllogaritur mbi bazën e mesatares së çmimeve të marra nga studimi i tregut, duke reflektuar çmimet reale të tregut për shërbimet e mirëmbajtjes së sistemit Hibrid Mail, përfshirë mirëmbajtjen parandaluese dhe korrigjuese, asistencën teknike, furnizimin me pjesë këmbimi sipas nevojës dhe ndërhyrjet e specializuara teknike.

Përlllogaritja e fondit limit është kryer në mënyrë që të sigurojë përdorimin me efektivitet të fondeve publike, duke garantuar njëkohësisht realizimin e shërbimit sipas kërkesave teknike dhe operacionale të Autoritetit Kontraktor, si dhe pjesëmarrjen sa më të gjerë të operatorëve ekonomikë në procedurën e prokurimit.

Vlera limit e kontratës konsiderohet reale, e argumentuar dhe në përputhje me kushtet aktuale të tregut për shërbime të kësaj natyre.

AFATI I OFRIMIT TË SHËRBIMIT: do të jetë për 12 (dymbëdhjetë) muaj kalendarike nga nënshkrimi i kontratës

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(ndryshuar), autoriteti/enti kontraktor **SH.A. Posta Shqiptare**, ka hartuar

procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(ndryshuar)

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe nenit.....

(shënim: plotësoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nëligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale në fjalë).

2.2. **Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), **ku vlera e xhiros për periudhën e kërkuar të jetë jo më pak se 95% e vlerës limit të kontratës që prokurohet.**

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. I ndryshuar

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

(Kërkesa e lartpërmendur do i shërbejë autoritetit kontraktor si tregues për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Kjo në përputhje me nenin 77 të LPP dhe nenin 43 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”).

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin Nr. 29/2023 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: përditësuar në datë 11.12.2025 “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori Ekonomik ofertues duhet të vërtetojë që ka realizuar Shërbime të ngjashme, me vlerë jo më pak se 39 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- a) Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbylljen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e furnizuara.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e furnizuara.

Shënim: *Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikuar*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdosshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose

furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatat ISO, të lëshuara nga Organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

- ISO 9001-2015 (për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë) ose ekuivalente të vlefshme.
- ISO 27001:2013 (për Sigurinë e Informacionit) ose ekuivalente të vlefshme

Në rast të BOE secili O.E duhet të paraqesë ISO-t e sipërcituara në përputhje me zërat e shërbimeve që do të marrë përsipër të realizojë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në 77, 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Ky kriter e siguron AK që Sherbimi që do të prokurohet do të jetë i cilësisë së lartë dhe sipas standardeve EU ISO 9001-2015 ose ekuivalente. Sistemi i menaxhimit të cilësisë siguron AK që operatori zotëron aftësitë për të ofruar shërbime që plotësojnë pritshmëritë, kërkesat dhe specifikimet e klientit përmes aplikimit efektiv dhe cilësor të tij.

Argumentimi: Ky kriter e siguron AK që Sherbimi që do të prokurohet do të jetë sipas standardeve në fushën e menaxhimit të sigurisë së informacionit ISO 27001:2013 ose ekuivalente.

Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit siguron AK që operatori ekonomik aplikon, mirëmban dhe përmirëson në mënyrë të vazhdueshme një përjasje sistematike në menaxhimin e informacionit sensitiv me fokus tek siguria.

- Në rast të BOE secili O.E duhet të paraqesë ISO-t e sipërcituara në përputhje me zërat e shërbimeve që do të marrë përsipër të realizojë.

2.3.3 Operatori ekonomik për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të ketë në stafin e tij punonjës të specializuar/të kualifikuar, të cilët duhet të figurojnë në Formularët E- Sig te listepagesat për muajt Mars Prill Maj, si më poshtë:

- a) Minimumi 1 (nje) punonjes te certifikuar nga prodhuesi per pajisjen e prinimit inkjet (i pajisur me certifikate dhe Service Key aktiv).
- b) Minimumi 1 (një) punonjës te certifikuar nga prodhuesi per pajisjen UPS ose ekuivalente
- c) Minimumi 1 (një) inxhinier mekanik ose ekuivalente.
- d) Minimumi 1 (një) inxhinier elektrik per automatizim ose ekuivalente.

e) Minimumi 1 (një) inxhinier elektronik ose ekuivalente

*Sqarim** Lidhur me certifikimet, një punonjës mund të zotërojë më shumë se një certifikim të kërkuar për të përmbushur kriterin).

Argumentimi: : Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, dhe i referohet garancisë së Autoritetit Kontraktor për realizimin e shërbimeve. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Punonjesit e mësipërm janë kërkuar sipas funksionit që do të kryejnë për kryerjen e shërbimit objekt prokurimi, për të treguar qëndrueshmërinë dhe besueshmërinë e operatorit ekonomik ofertues për realizimin me sukses të objektit të prokurimit.

Sistemi Hibrid Mail përbëhet nga pajisje dhe komponentë të specializuar mekanikë, elektrikë, elektronikë dhe sisteme të printimit industrial, të cilat kërkojnë personel të kualifikuar dhe të certifikuar për diagnostikimin, mirëmbajtjen dhe riparimin e tyre. Për këtë arsye kërkohet që operatori ekonomik të disponojë staf teknik të specializuar, i cili të ketë njohuritë dhe kualifikimet e nevojshme për ndërhyrje në të gjithë komponentët e sistemit.

Kërkesa për:

- **1 punonjës të certifikuar nga prodhuesi për pajisjen e printimit inkjet**, garanton kryerjen e ndërhyrjeve sipas standardeve të prodhuesit dhe përdorimin korrekt të procedurave teknike për mirëmbajtjen e pajisjes kryesore të sistemit;
- **1 punonjës të certifikuar për pajisjen UPS ose ekuivalente**, garanton mirëmbajtjen dhe funksionimin e pandërprerë të sistemit të furnizimit me energji;
- **1 inxhinier mekanik**, garanton mbulimin e problematikave që lidhen me pjesët mekanike dhe lëvizëse të linjës;
- **1 inxhinier elektrik për automatizim**, garanton mirëmbajtjen e sistemeve elektrike dhe të kontrollit automatik;
- **1 inxhinier elektronik**, garanton diagnostikimin dhe mirëmbajtjen e qarqeve elektronike dhe komponentëve të kontrollit të sistemit.

Kërkesa që këta punonjës të figurojnë në listëpagesat dhe formularët E-SIG për muajt Mars, Prill dhe Maj synon të vërtetojë disponueshmërinë reale të personelit dhe kapacitetin aktual të operatorit ekonomik për përmbushjen e kontratës.

2.3.4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë që garanton kryerjen e shërbimit dhe furnizimin me të gjitha pjeset e nevojshme për funksionimin e pajisjes .

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër ofrimin e shërbimit dhe furnizimin e pjesëve që nevojiten. Kjo deklaratë shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor që shërbimi objekt prokurimi është në

përputhje me specifikimet teknike dhe në rast defekti të ndodhur , të gjitha riparimet dhe shërbimet e përcaktuara në deklaratë do të kryhen te operatori ekonomik kontraktues.

2.3.5 Autorizim Prodhuesi ose Distributori te autorizuar nga prodhuesi per pjeset e kembimit te ofruara. Autorizimi duhet te jete i dedikuar per kete procedure dhe te mbaje te dhena te sakta te kontaktit te prodhuesit te vlefshme ne rast nevojje per verifikim.

Argumentim: Ky kriter vendoset në mbështetje të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, me qëllim garantimin e furnizimit me pjesë këmbimi origjinale dhe të certifikuara nga prodhuesi gjatë periudhës së zbatimit të kontratës së mirëmbajtjes së sistemit Hibrid Mail.

Kërkesa për paraqitjen e autorizimit nga prodhuesi ose distributori i autorizuar siguron që operatori ekonomik ka mbështetjen e nevojshme teknike dhe akses të ligjshëm në pjesët e këmbimit, duke garantuar cilësinë, përputhshmërinë dhe funksionimin normal të pajisjeve dhe komponentëve të sistemit. Gjithashtu, autorizimi i dedikuar për këtë procedurë mundëson verifikimin e autenticitetit të dokumentacionit dhe të marrëdhënies së operatorit ekonomik me prodhuesin, duke minimizuar riskun e furnizimit me pjesë jo origjinale ose të papërshtatshme.

Sqarim! Të gjitha kriteret e sipërcituara në **Shtojca 9 të DST-së**, të cilat përfshihen në përcaktimet e pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet: “*Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas **Shtojca 10, të DST-së, do të vlerësohen të përmbushura në fazën e vlerësimit të ofertave të ofertuara në SPE.***”

Referuar përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, si dhe përcaktimet e pikës 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet: “Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i kërkojë ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin...”, **Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara lidhjes së kontratës duhet të paraqesë në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike**

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

NJËSIA E PROKURIMIT